



Projekti Strategjik **'mat'** Zhvillimi i Integruar i Bashkisë Pogradec

Mjedis Agrobiznes **Turizëm**



**Eduart
KAPRI**





Projekti Strategjik “mat” Zhvillimi i Integruar i Bashkisë Pogradec

Kandidati për Kryetar i Bashkisë Pogradec, Eduart KAPRI

Të nderuar banorë të Bashkisë Pogradec,

Mes këtij dokumenti strategjik, ju bëjmë të njohur **Projektin tonë të Veprimit për periudhën 2015-2019**, si dhe fushat ku do të fokusohemi për zhvillimin socio-ekonomik të Bashkisë Pogradec, duke synuar një zhvillim të integruar, të shumëtrajshëm dhe të qëndrueshëm, në një terren administrativ që ofron mundësi dhe shanse për gjithësecilin, pa përjashtim, mes një Pushteti Lokal që do të orientojë aktivitetin e tij funksional tek **Partneriteti Publik-Privat**, si boshti kryesor i transformimit të Bashkisë së Pogradecit, në një Bashki me fizionomi europiane.



Bashkëqytetarët e mi,


Bashkia jonë është një prej zonave më të rëndësishme në vend, me një hapësirë gjeo-territoriale heterogjene (liqenore, kodrinore & malore), me pasuri të pashtershme të natyrës, por dhe me një popull vital, punëtor dhe të lidhur ngushtë me trevën në të cilën jeton.

Projekti Strategjik “mat”, një akronim ky i tre fushave kryesore të vëmendjes sonë qeverisësë në katër vitet e ardhshëm: (a) **Mjedis**; (b) **Agrobiznes**; (c) **Turizëm**, është Udhëzuesi dhe Udhërrëfyesi i punës së Bashkisë në vitet në vijim. Një plan i qartë ndërhyrjesh në territor, një plan i orientuar për të mbështetur sipërmarrjen (aktivitetit privat), një plan që mbështet dhe hap horizontet për përmirësimin dhe konsolidimin e sektorit të Turizmit, një Projekt i mirëplanifikuar, i mundshëm për t’u implementuar, me impakt të menjëhershëm në jetën e çdo banori dhe financiarisht i realizueshëm. Pogradeci, shikohet mes Projektit Strategjik “mat” si pjesë integrale e një territori më të gjerë, sesa vetë territori i shtrirjes administrative. Shikohet si pjesë e Euro-Rajonit, si një prej zonave më të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, me mundësi ë të shumta për zhvillimin e turizmit, agro-biznesit, hapësirës sipërmarrëse, artizanatit, peshkimit, industrisë së lehtë dhe ushqimore etj.

Falenderoj bashkëpunëtorët, konsulentët e mi dhe të gjithë ata që mes ideve të tyre dhe punës së përkushtuar, kontribuan në hartimin e Projektit tonë Strategjik për drejtimin e Bashkisë Pogradec.

Eduart KAPRI





Bashkia e Pogradecit, e shtrirë në brigjet jugore dhe perëndimore të Liqenit të Ohrit, mbi malet e Mokrës, në një terren heterogjen (liqenor, kodrinor dhe malor) është e njohur për potencialet e saj natyrore dhe dihet se cilësia e jetës së banorëve të çdo zone, është direkt e vartur nga cilësia e mjedisit (mjedis i parë në prizmin e hapësirës territoriale). Projekti ynë Strategjik “mat” është një plan aktivitetesh dhe ndërhyrjesh për përmirësimin e mjedisit / hapësirës urbane dhe rurale, gjatë katër viteve në vazhdim, mes veprimesh dhe shërbimesh, që do të jenë të aksesueshme, ambjentalisht dhe financiarisht të qëndrueshme. Mandati i parë në drejtimin e Bashkisë Pogradec, do të jetë tërësisht i fokusuar në përmbylljen e këtij Plani gjigand, për nga dimensionin dhe impaktin në jetën e gjithësecilit, në jetën e çdo banori të Bashkisë Pogradec, si Plan vizionar për të ardhmen e Bashkisë, Plan miqësor për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj, Plan ambicioz për t’i dhënë Pogradecit fizionominë e tij të vërtetë, dhe padyshim do të jetë Plan që do t’i vijë në shërbim biznesit, teksa Bashkia do të jetë aleati i parë i iniciativës private, kudo ajo operon.

Të gjithë njohim mirë problematikat e Bashkisë ku jetojmë, zhvillimin e paplanifikuar, spontan dhe kaotik, ndikuar nga ndryshime të mëdha demografike, na mbetet t’i evidentojmë dhe t’i analizojmë këto problematika, si dhe të bashkëpunojmë për krijimin e një bazamenti strategjik, platforme mundësish, për zhvillim të orientuar dhe të integruar.

MASTER PLANI URBAN - MJEDISOR I BASHKISË POGRADEC (Plani Rregullues i Territorit)

Bashkia e Pogradecit mes Projektit tonë Strategjik “mat”, ka objektiv të sajën primar, hartimin e MASTER PLANIT URBAN – MJEDISOR (Plani Rregullues i Territorit), si dokumenti më i rëndësishëm, mbi të cilin do të shtrihet i gjithë aktiviteti publik dhe privat, për të hedhur bazat e një Zhvillimi të Planifikuar dhe të qëndrueshëm urban, për të shmangur spontanitetin në ndërhyrjet në territor dhe gabimet e bëra. Plan, i cili do të shërbejë si busull orientimi për zhvillimin e ekonomive lokale, brenda territorit të Bashkisë. MASTER PLANI do të hartohet në partneritet me ekspertë vendas dhe të huaj dhe do të jetë Udhëzuesi për Zhvillimin e Integruar të Pogradecit.

Plani Urban - Mjedisor do të jetë instrument i rëndësishëm për të adresuar çështjet dhe problematikat mjedisore dhe urbane, në një kuadër të sistemuar dhe të planifikuar në terma afatgjatë, për veprim dhe ndërhyrje në territor. Bashkia jonë përballë sot me problematika të mëdha urbane dhe mjedisore, duke përmendur: mungesën e kanalizimeve të sistemit të ujërave të zeza dhe të bardha, mungesën e ujit të pijshëm, mungesën e shërbimeve bashkëkohore për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve, mungesën e një rrjeti rrugor bashkëkohor, ndotjen e pasurive hidrike nga vetë njeriu, apo nga aktiviteti privat, ndotjen e ajrit, ndotjen e tokës nga mbetje toksike dhe hazarde etj.

Problemet urbane dhe mjedisore janë shumë komplekse dhe gjenerohen nga faktorë multi-sektorialë. Ndaj dhe,

që në javët e para të punës sonë në Bashkinë e Pogradecit, do të piketojmë prioritetet për veprim, duke vendosur qëllime të qarta dhe të detajuara, për fillimin e menjëhershëm të hartimit të MPUM-së, duke i dhënë përparësi mjedisit natyror dhe atij urban, që është dhe terreni ku jetojmë dhe aktivizohemi. Vetëm mes një Planifikimi të qartë, do të mund të vendosim në kuadër rregulli, veprimtarinë dhe ndërhyrjet e sektorit publik dhe atij privat mbi territor.

1. Vizioni i MPUM-së

Vizioni ynë për Bashkinë e Pogradecit, është vizioni për të krijuar qytet dhe fshatra cilësisht të banueshëm për të gjithë, të përshtatshëm për aktivitetin e gjithkujt, të aksesueshëm dhe atraktivë për rezidentët aktualë, me qëllim shmangien e ndryshimeve demografike të kushtëzuara nga efekti ekonomik 'domino', mes insistimit tonë që, banorëve të fshatrave të Bashkisë Pogradec, t'u jepet mundësia të jetojnë dhe punojnë atje, me shanse të barabarta me banorët e zonave urbane, për të zhvilluar aktivitetin e tyre, mes mbështetjes absolute që do t'u jepet nga Pushteti Vendor, duke i mëshuar faktit se zona rurale në Bashkinë tonë është zona kryesore e prodhimit të produktit vendas, si baza e ekonomisë lokale.

2. Parimet e MPUM-së


Partneriteti mes aktorëve, grupeve të interesit dhe Pushtetit Vendor:

1. Ndërtimi i partneritetit për të gjetur zgjidhje përballë sfidave, por edhe oportuniteteve mjedisore dhe urbane, brenda kufijve gjeografikë dhe administrativë të Bashkisë.
2. Komunikim dhe diskutime me publikun për hartimin e Planit më të rëndësishëm për zhvillimin e Pogradecit tani dhe në dekadat në vazhdim.
3. Përfshirja e praktikave më të mira dhe inovative në ideimin dhe hartimin e MPUM-së, për një Plan afatgjatë.
4. Punë e përbashkët për të përmbushur objektivat mjedisore dhe urbane mes një kuadri të përgjegjshëm vlerësimi kostosh dhe benefitesh, si dhe veprimesh të propozuara me impakt social.
5. Bërja publike dhe transparente e vendimmarrjeve lidhur me hartimin e MPUM-së.
6. Përfshirja e masave të matshme për të siguruar përmbushjen e nevojave afatgjata, për një mjedis urban të qëndrueshëm.
7. Do të sigurohemi që veprimet lokale do të kontribuojnë në zgjidhje të çështjeve mjedisore rajonale dhe globale.
8. Do të aplikojmë metodën e menaxhimit të adaptueshëm, si komponent 'kyç' në ciklin e planifikimit, për të siguruar elasticitet në proces, deri në definimin e MPUM-së.

Do të hartojmë një Plan Rregullues të Territorit që synon:

1. Zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik;





2. Bashkëndim horizontal dhe vertikal mes aktorëve vendorë dhe kombëtarë të planifikimit, si dhe palëve të interesuara;
3. Planifikim të detyruar, që garanton zhvillimin e territorit vetëm mbi bazën e instrumentave të planifikimit, duke shmangur zhvillimin kaotik të deritanishëm;
4. Respektim rigoroz të kriterëve mjedisore;

3. Konteksti i MPUM-së

Plan urban - mjedisor do të përcaktojë qartë ndarjen zonale të territorit të Bashkisë Pogradec, destinacionin e çdo zone dhe funksionin e saj, si pjesë integrale e së tërës.

MPUM-ja do të përcaktojë politikën e menaxhimit të territorit dhe të zonave në:

1. Urbane / rurale rezidenciale;
2. Tregtare / industriale;
3. Bujqësore / blegtorale /;
4. Turistike / hotelerike / kreative;
5. Pyjore;
6. Zona të mbrojtura;
- 7: Fusha e mbetjeve etj.

Planifikimi Mjedisor & Vendimarrja mbi Mjedisin do i referohen dhe do të marrin në konsideratë nevojat e shoqërisë, komunitetit, banorëve, me qëllim final zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar, tërësisht të harmonizuar, për të sjellë në akord 'terrenin me funksionet e individit'.

Planifikimi mjedisor është për ne, i rëndësishëm së veçantë, kur përballemi me çështjen e mbrojtjes së mjedisit, konservimit dhe rigjenerimit të tij, duke synuar një mjedis të qëndrueshëm për gjeneratat që vijnë.

Planifikimi Mjedisor do të jetë procesi i vlerësimit të faktorëve socialë, politikë, ekonomikë, qeverisës, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt mjedisin, teksa i referohemi zhvillimit në tërësi. Qëllimi i Planifikimit Mjedisor do të jetë krijimi i një marrëdhënieje të ekuilibruar mes banorëve dhe mjedisit. Mes këtij planifikimi mjedisor, banorët do të fitojë, teksa u jepet mundësia për ta përdorur mjedisin në forma produktive, kurse mjedisi do të fitojë, teksa do të sigurojë mbrojtjen dhe konservimin e tij nga vetë banorët, për gjeneratat që vijnë.

Do të studiojmë me grup ekspertësh, që prej startimit të drejtimit të Bashkisë, tre komponentët bazë:

1. **Situatën aktuale mjedisore**, duke vlerësuar në statistika burimet natyrore të tokës, si dhe infrastrukturën ekzistuese dhe ndërtimet.
2. Planifikimin mjedisor do e shohim si **vizion** për zhvillim, me objektiva të matshëm, që marrin parasysh rregu-

llat, legjislacionin dhe nevojat e komunitetit. Do të jetë një vizion i konvertuar në veprim, duke angazhuar potencialin human dhe teknologjik që ka Bashkia, në përmbushje të objektivit.

3. Planifikimin mjedisor do e trajtojmë si një **studim kompleks** ku do të harmonizohen dhe alternohen nevojat e mjedisit dhe individit, pa cënuar njëri-tjetrit, por duke i ardhur në shërbim njëri-tjetrit.

Plani do të hartohet me qëllim arritjen e një zhvillimi të koordinuar dhe harmonik të Bashkisë në të gjithë shtrirjen e saj territoriale, në përputhje me nevojat e së tashmes dhe së ardhshmes më të mirë, si dokument mbështetës për hartimin e Master Planit Urban-Mjedisor, duke promovuar një mjedis më të mirë, rend në mjedis, komoditet, përmirësimin të kushteve të jetesës dhe mirëqenie të përgjithshme, si dhe efikasitet të ekonomisë në procesin e zhvillimit, duke menaxhuar siç duhet fondet publike dhe të gjitha fondet që do të burojnë nga programe, donatorë dhe partnerë vendas dhe të huaj.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) do të jetë instrumenti ndihmës në vendimmarrje, që do të plotësojë procesin e planit strategjik, me: (i) vlerësime të qëndrueshme për mjedisin dhe çështje të tjera relevante me të; (ii) diskutime të mirëstrukturuara me komunitetin dhe pushtetin lokal; dhe (iii) një mekanizëm për të marrë rezultatet që do të burojnë nga vlerësimet dhe diskutimet me komunitetin. Me fjalë të tjera, VSM-ja në vetvete do të jetë një formë për të shkëmbyer informacionin, për të rritur pjesëmarrjen e aktorëve dhe faktorëve komunitarë në vendimmarrje, si dhe transparencën me publikun, në definimin e planit strategjik për zhvillimin mjedisor dhe urban të Bashkisë Pogradec.

Domosdoshmërinë e një plani urban dhe mjedisor të detajuar për Pogradecin, e shikojmë si punën e parë të Bashkisë dhe si shtratin ku do të evoluojnë dhe ndërveprojnë çështjet mjedisore, sociale dhe ekonomike.


Plani ynë do të jetë plani mbi të cilin do të veprojnë, operojnë dhe aktivizohet e gjithë jeta social-ekonomike, duke menduar dhe parashikuar zhvillimin afatgjatë të Pogradecit, me vizion disa dekadash më pas, duke aplikuar sot, ide dhe projekte, që do i shërbejnë së nesërme.

Master Plani Urban - Mjedisor do të jetë instrumeti më i vlefshëm që qeverisja jonë vendore do i japë dhe i lërë trashëgim Bashkisë së Pogradecit, për të orientuar mes tij zhvillimin e sigurt të sektorëve të jetës sociale dhe ekonomike, me fokus: përmirësimin e cilësisë së jetesës; planifikimin korrekt dhe të duhur të investimeve infra-



strukture publikë dhe private; mbështetjen e sipërmarrjes; konsolidimin e sektorit të turizmit; kthimin e Pogradecit në destinacion turistik përpos standarteve europiane.

Pas hartimit të MPUM-së, përpjekjet tona të përbashkëta, do i drejtohen më pas, një prej organizatave më të rëndësishme të Kombeve të Bashkuara, UNESCO.



PLANI I VEPRIMIT në kuadër të prioriteteve të Projektit Strategjik “mat”

1. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve. Planifikimi i shtrirjes dhe modernizimit të rrjetit rrugor që është nën juridiksionin e Bashkisë, në zonat urbane dhe rurale;

2. Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza në të gjitha fshatrat e Bashkisë Pogradec;




3. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ujësjellësave për të siguruar furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm;


4. Ndrëtimi publik në të gjitha hapësirat e banuara, lagje dhe fshatra, si dhe përdorimi i burimeve alternative të energjisë në qytetin e Pogradecit.



5. Politika menaxheriale për reduktimin e mbetjeve, grumbullimin dhe riciklimin e tyre; Organizimi i sistemit të grumbullimit të mbetjeve; Krijimi i 'landfill-it' (vendgrumbullimit të mbetjeve), si dhe krijimi i qendrës së riciklimit në qytetin e Pogradecit.



6. Vendosja e kazanëve për grumbullimin e mbetjeve në zonat e banuara, sipas standarteve europiane, në raport me dendësinë e popullsisë dhe shtrirjen lineare të banesave brenda një lagjeje, apo një fshati; Vendosja e koshave të vegjël për hedhjen e mbeturinave, çdo 100m linear rruge në rrjetit kryesor dhe dytësor të zonave të banuara.



7. Shtimi i zonave dhe hapësirave të gjelbra brenda zonave të banuara dhe bllok-pallateve, të ideuara si zona çlodhjeje dhe kreativiteti; Rehabilitimi i parqeve ekzistuese;

8. Hartimi i Planit të Veprimit për mbrojtjen dhe pastrimin e Liqenit dhe Bregliqenit; Ndërtimi i molit kryesor në Liqenin e Dhrut dhe ndërtimi i disa urave mol, me qëllim stacionimin e varkave dhe anijeve të vogla, si dhe mjeteve të tjera lundruese, në raste aktiviteteve sportive hidrike, si: kanotazh, gara noti, surfing etj.;

9. Përgjatë bregut të liqenit, në partneritet me sektorin privat, për çdo 50m linear do të vendosen kosha statikë për hedhjen e mbeturinave. Për periudhën Maj - Shtator, grumbullimi i mbetjeve do të kryhet dy herë në ditë;



10. Çdo vit për periudhëm Maj-Shtator do të funksionojnë dy grupe pune përgjatë vijës së bregliqenit: a. Grupi i pastrimit dhe mirëmbajtjes; b. Grupi i shpëtimit dhe kontrollit të sipërfaqeve hidrike, për të qënë pranë turistëve dhe mjedisit;

11. Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i varrezave të qytetit të Pogradecit; Mirëmbajtja, rehabilitimi dhe rrethimi i varre-

zave në të gjitha fshatrat e Bashkisë Pogradec;

12. Bashkëpunim i Pushtetit Vendor me Shoqata të Shoqërisë Civile, që kanë në fokus të aktivitetit të tyre, mbrojtjen, konservimin dhe promovimin e mjedisit në Bashkinë e Pogradecit; Angazhimi i rinisë në mbështetje të iniciativave mjedisore, që do të merren periodikisht, në të gjithë hapësirën territoriale administrative të Bashkisë Pogradec;

13. Plan studimi dhe veprimi (studim fizibiliteti), për kthimin e mbetjeve organike të kafshëve (gjësë së gjallë të blegtorëve) në burim alternativ energjie (peleta) dhe përdorimi i tyre për ngrohjen e kopshteve të fëmijëve dhe shkollave, duke minimizuar kështu, përdorimin e druve të zjarrit dhe lëndëve të tjera djegëse;




14. Veprime konkrete për mbrojtjen dhe rigjenerimin e mjedisit natyror (pyje, lumenj, përrenj), florës dhe faunës;

15. Politika për reduktimin e konsumit të burimeve natyrore pa kriter;


16. Hartimi i projektit për ndërtimin e Stacionit të Linjave Urbane dhe Inter-urbane të transportit të pasagjerëve (si pjesë integrale e MPUM-së);


17. Vendosja e linjës urbane Tushemisht - Lin për banorët e zonave më të rëndësishme turistike të Bashkisë, si një linjë urbane në shërbim edhe të vizitorëve dhe turistëve. Linja e autobuzit urban do të hyjë në funksion brenda 6-mujorit të parë të legjislaturës 2015-2019.






Linja Urbane Tushemisht - Lin - Tushemisht







Agrobiznesi, boshti i ekonomive lokale në zonat kodrinore dhe malore të Bashkisë Pogradec, do të jetë një prej tre prioritete të drejtimit dhe qeverisjes.

Agrobiznesi i parë si një 'sistem', përmbledh brenda vetes shumë profesione, teksa e përbëjnë një seri aktiviteteve sipërmarrëse, të koordinuara, që kontribuojnë në prodhimin, përpunimin, tregtimin, shpërndarjen, financimin dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore, produkteve blegtorale, si dhe burimeve të tjera natyrore.

Bujqësia - Blegtoria

Bashkia do të ndihmojë në planifikimin e metodave të menaxhimit të sektorit, për të organizuar menjëherë një sistem vlerësimi të funksionimit të të gjithë fermerëve, apo sipërmarrjeve që aktivizohen në bujqësi dhe blegtori, duke shqyrtuar fillimisht burimet e tyre ekonomike, njerëzore dhe materiale, duke vlerësuar gjendjen aktuale në të cilën gjenden, si fundament për të hartuar planin e ndihmës kundrejt këtyre bizneseve, që sot hasin vështirësi dhe probleme, nga mungesa e vëmendjes, mungesa e infrastrukturës dhe nga mungesa e organizimit.

"Monopati" i menaxhimit të burimeve njerëzore, domethënë i vetë fermerëve, do të fokusohet në ndihmesën që do u japë Pushteti Lokal fermerëve, përsa i përket planifikimit, masave mbrojtëse ndaj produkteve që kultivojnë dhe prodhojnë, përzgjedhjes së kulturave bujqësore, orientimit të tyre drejt tregut, vlerësimin të arritjeve, dëmshpërblimeve në raste katastrofash natyrore, si dhe sigurisë në punë.


Mbështetje administrative për fermerët në sektorin e bujqësisë


Bashkia e Pogradecit mes administratës së saj do të lehtësojë veprimtarinë sipërmarrëse të banorëve që angazhohen në sektorin e bujqësisë, mes ndihmesës direkte profesionale që specialistët do u japin fermerëve, mbështetjes teknike, dhënies së informacionit, grumbullimit dhe vlerësimin të të dhënave, gjurmimit të tregjeve, afrimit të partnerëve, bashkëpunimit me donatorët e mundshëm. Të gjitha këto, me qëllim mbështetjen e banorëve që jetën e tyre e kanë lidhur me prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Marketing-u i prodhimeve bujqësore

Bashkia Pogradec do të kthehet në "instrument" për Marketing-un e produkteve që prodhojnë fermerët e zonës. Bashkia do të angazhohet me specialistëve të saj, partnerëve dhe konsulentëve të jashtëm, për hartimin dhe zbatimin e politikave efektive të Marketing-un, reklamës dhe promovimit, do të jetë nxitëse e veprimtarive për rritjen e qarkullimit të produktit në treg, me bashkëpunimeve bilaterale me homologë në Ballkan, me studimesh për Marketing-un, merchandising, me krijimin dhe konsolidimin të marrëdhënieve të fermerëve dhe kompanive të Pogradecit, me Dhoma Tregtie në vendet fqinje dhe jo vetëm.

Bashkia do të jetë nxitësi për partneritet dhe bashkëpunim, kudo që ky të jetë i mundshëm dhe i realizueshëm.





*** Politika mbështetëse për Zhvillimin e Bujqësisë në Bashkinë e Pogradecit**

- Ndhimesë direkte për fermerët (prodhues & tregtarë) në hartimin e Plan Bizneseve për zgjerimin dhe zhvillimin e fermave të tyre;
- Bashkia në bashkëpunim me organizata dhe institucione relevante me sektorin, do të marrë masa për gjurmimin dhe gjetjen e tregjeve të shitjes së produkteve;
- Bashkia Pogradec do të punojë intensivisht në mirëmbajtjen dhe hapjen e kanaleve për ujitjen, vaditjen dhe kullimin e tokave bujqësore të fermerëve të zonës;
- Do të hartojë studime për bio-energjinë;
- Do të hartojë politika çertifikimi, duke mbështetur fermerët në prodhim produktesh cilësore dhe konkurrente në treg, me dy brande; "Mokra" & "Pogradec". Kjo etiketë do të përfaqësojë produktet e zonës, për t'i bërë ato të dallueshme në tregun vendas dhe të huaj;
- Do të përdoren të gjitha hapësirat për reklamimin e produkteve;
- Do të hartohen studime për konsolidimin e marrëdhënies së natyrshme midis Bujqësisë, Mjedis dhe faktori Njeri;
- Do të mbështeten idetë inovatore përsa i përket prodhimit, menaxhimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore;
- Bashkia do të orientojë fermerët drejt prodhimit të kulturave bujqësore që kërkon tregu vendas dhe i huaj, për t'i kthyer fermat e tyre në sipërmarrje efektive, fitimprurëse dhe efikente;
- Bashkia do të bëjë analiza periodike të çmimeve dhe tregjeve, për t'i ardhur në ndihmë fermerit, duke e parë atë si prodhues dhe si tregtar;
- Krijimi i Rrjetit të Informacionit, logjistikës dhe statistikës për sektorin e Bujqësisë;
- Përdorimi i Buletinit të Bashkisë, për promovimin e politikave të zhvillimit në sektorin e Bujqësisë;

*** Marrëdhëniet me partnerët, organizmat dhe institucionet vendas & të huaj për Zhvillimin e Bujqësisë**


- Dalja në tregun e huaj mes politikash bashkëpunimi bilateral, në nivel Qeverisjeje Lokale;
- Analiza e politikave të prodhimit dhe tregtimit të produkteve në vendet e Ballkanit;
- Bashkëpunimi me Dhomat e Tregtisë & Industrisë, kryesisht në vendet e Ballkanit;
- Bashkëpunimi me DBT (Organizatën Botërore të Tregtisë), ECE (Komisioni Ekonomik për Europën), si dhe Agjensi të vendeve të tjera që operojnë gjithashtu në Shqipëri, për mbështetje teknike dhe financiare të fermerëve;

*** Fonde në mbështetje të zhvillimit të Sektorit të Bujqësisë**

- Fonde lokale dhe rajonale, grante shteti, si dhe fonde nga të ardhurat e Pushtetit Vendor;
- Fonde që burojnë nga projekte ndërkufitare të BE (IPA), nga projekte të BE-së për Europën Jug-Lindore, apo fonde që burojnë nga organizma dhe donatorë që operojnë në Shqipëri, të fokusuar në sektorin e bujqësisë.



Krijimi i "Rrjetit të Fermerëve të Bashkisë Pogradec / Prodhues dhe Tregtarë të Produkteve Bujqësore"



Tre nënsektorët në të cilët aktivizohen fermerët e zonës:

- * Prodhime nga toka bujqësore;
- * Pemtari;
- * Vreshtari

- Bashkia do të ndërmarrë brenda tre muajve të parë të punës së saj, iniciativën për krijimin e Rrjetit të Fermerëve të Pogradecit, regjistrimin vullnetar të të gjithëve në një bankë të dhënash, duke e parë këtë formë organizimi si më efikase dhe më frytdhënëse, për të koordinuar aktivitetin prodhues dhe tregtar të fermerëve, si dhe për t'i dhënë mundësi produkteve, që të kenë brand-in e tyre "Mokra" & "Pogradec", për të nxjerrë pas disa kohësh prodhime të çertifikuara në tregun vendas dhe të huaj;

- Bashkia do të mundësojë mes Partneritetit Publik - Privat hapjen e katër pikave të grumbullimit, magazinimit dhe frigoriferimit të produkteve bujqësore, që paralelisht do të shërbejnë edhe si tregje të shitjes së produkteve bujqësore;

- Bashkia - Rrjeti FBP - Partnerë: kjo formulë bashkëpunimi do të sjellë frytet e saj shumë shpejt në kohë, teksa është provuar dhe praktikuar me sukses në shumë vende të Bashkimit Europian, kryesisht në zona ku sektori i Bujqësisë është primar për ekonominë lokale.

- Do të hartohet projekti për hapjen e një Fabrike të Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, për përpunimin dhe konservimin e fruta-perimeve;

- Bashkia do të mundësojë mes Partneritetit Publik-Privat hapjen e dy kantinave për prodhimin e verës, duke i dhënë kështu një suport real zhvillimit të nënsektorit të vreshtarisë;

Mes kësaj forme organizimi, Bashkia do të jetë realisht promotor dhe nxitës i fermerit, kudo që ai ndodhet, duke i siguruar atij, një terren sa kompetitiv, po aq edhe të ndershëm, si dhe do e nxisë fermerin për të dalë nga "guacka" e individualitetit në prodhim, veprimtarisë brenda një ferme të vogël, duke parë mundësi bashkëpunimi me fermerë të tjerë të zonës, me qëllim final: më shumë prodhim, cilësi më të lartë të produkteve, produkte konkurruese në treg, të ardhura të kënaqshme, duke siguruar kështu, më shumë mirëqenie, një jetë më të mirë.



* Politika mbështetëse për Zhvillimin e Blegtorisë në Bashkinë e Pogradecit

- Ndhimesa për fermerët blegtorë do të ndjekë të njëjtat politika si dhe me bujqësinë, por më specifkisht fokusi do të jetë në priotitetet e renditura, si më poshtë:



Krijimi i “Rrjetit të Blegtorëve të Bashkisë Pogradec”

- Bashkia do të ndër marrë brenda tre muajve të parë të punës së saj, iniciativën për krijimin e Rrjetit të Blegtorëve, regjistrimin vullnetar të të gjithëve në një bankë të dhënash, duke e parë këtë formë organizimi si më efikasen dhe më frytdhënësen, për të koordinuar grumbullimin dhe shitjen e prodhimit blegtoral;

- Bashkia do të mundësojë mes Partneritetit Publik-Privat hapjen e tre baxhove për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e nënprodukteve të tij, për t'i dhënë mundësi blegtorit që të mos e humbasë prodhimin e qumështit, teksa konsumon kohën për shitjen e produktit të tij të papërpunuar në treg, që në të shumtën e rasteve prishet, por edhe mes produktit të tij të papërpunuar, blegtori vë në rrezik shëndetin e popullatës. Krijimi i tre baxhove, do u japë mundësinë blegtorëve ta shesin produktin ‘qumësht’ në baxho, duke shmangur humbjen e kohës dhe riskun e prishjes së produktit, paralelisht blegtorit i jepet mundësia të përmirësojë dhe shtojë gjënë e gjallë, si dhe të investojë për ushqim më të mirë për bagëtinë, për rrjedhojë edhe për një produkt më cilësor;

- Bashkia do të bashkëpunojë me blegtorët e të gjitha fshatrave, për të hartuar plan për secilin fshat, në mënyrë që blegtorët gjënë e gjallë ta mbajnë jashtë territorit të banuar të fshatit, duke ndikuar direkt në përmirësimin e mjedisit, duke i dhënë mundësinë fshatarëve të jetojnë në një territor të pastër, duke bërë një jetë më të shëndetshme dhe komode për të gjithë banorët. Një plan i plotë veprimi do të mbyllet brenda vitit të parë të punës së Bashkisë Pogradec, për të zgjidhur një herë e për gjithmonë jetesën e veçuar të banorëve, nga gjëja e gjallë.

- Bashkia - Rrjeti BBP - Partnerë: kjo formulë bashkëpunimi do të sjellë frytet e saj shumë shpejt në kohë, teksa është provuar dhe praktikuar me sukses në shumë vende të Bashkimit European, kryesisht në zona ku një prej sektorëve kryesorë të jetës ekonomike është blegtoria.

- Do të ndërtohet Tregu i Kafshëve, në pllajën kodrinore përballë fshatit Çërravë, do të bëhet rrethimi dhe parcelizimi i tij me gardhe druri, do të ndërtohen gjithashtu tualetat publike dhe rruga që të çon tek tregu.

Mes kësaj forme organizimi, Bashkia do të jetë realisht mbështetës i blegtorit, duke i siguruar atij shitjen e prodhimit dhe duke e mbështetur atë që të vazhdojë të jetojë dhe punojë në fshat, duke patur të ardhme të sigurt.

* Politika mbështetëse për Zhvillimin e Sektorit të Peshkimit dhe Akuakulturës në Bashkinë e Pogradecit

Zhvillimi i veprimtarisë së peshkimit është i rëndësishëm për ekonominë dhe punësimin në Bashkinë Pogradec, kryesisht në zonat buzë liqenit: Buçimas, Pogradec, Udënisht.

- Do të hartohet Plani për krijimin e moleve të stacionimit të varkave të peshkatarëve, përgjatë gjithë vijës bregliqenore;
- Do të nxitet dhe mbështetet sektori privat ekzistues, që operon në përpunimin dhe konservimin e peshkut;
- Nxitja dhe implementimi i politikave rregullatore për peshkimin;
- Hyrja në negociata bashkëpunimi dhe mbështetjeje financiare me Këshillin e Peshkimit në Bashkimin Europian, një prej strukturave efikase dhe tejet mbështetëse për sektorin.
- Financimi i projekteve në fushën e kërkimit dhe përmirësimit të formave të menaxhimit të sektorit të peshkimit.

Niveli i Taksave dhe Tarifave Vendore për Zonën Rurale të Bashkisë Pogradec

Bashkia Pogradec do të aplikojë dy sisteme Taksash dhe Tarifash Vendore për biznesin, me dy nivele të ndryshme mes Zonave Rurale dhe Zonave Urbane.


Fermerët, Blegtorët, Peshkatarët dhe Sipërmarrësit në Zonat Rurale, do të kenë taksa më të ulta se Sipërmarrja në Zonën Urbane (në qytetin e Pogradecit).

Do të jetë kjo një formë për të nxitur sipërmarrësit, fermerët dhe blegtorët, që të qëndrojnë dhe të aktivizohen në Zonat Rurale, në fshatrat e tyre, që të punojnë tokën që kanë në pronësi dhe t'i marrin frytet asaj, domethënë të gjenerojnë të ardhura për familjet e tyre. Sektori i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale është ndoshta sektori më i rëndësishëm në ekonominë lokale, burimi kryesor i të ardhurave për agro 55% të banorëve.

Taksat në Zonat Rurale do të shkojnë në minimumin e mundshëm, mes një marrëveshje me biznesin dhe nga ana tjetër të gjitha taksat do të mblidhen në vlerën 100%, duke shmangur evazionin fiskal, sipërmarrjen ilegale dhe duke nxitur konkurrencën e ndershme.

Të gjitha bizneset do të jenë të ligjshëm dhe të githë do të paguajnë taksa të ulta, pa cënuar ekonominë e familjes së tyre.





Sipërmarrja Private dhe Pushteti Lokal

Hapësira sipërmarrëse kërkon vëmendjen e duhur të Pushtetit Lokal dhe mbështetjen maksimale të tij, sidomos në periudha të tilla krizash kombëtare, rajonale dhe globale.


Bashkia Pogradec do të ndërmarrë iniciativat që vijojnë, për sipërmarrjen private:


- Ulje të taksave dhe tarifave vendore në nivelet minimale, pas diskutimesh të hapura me komunitetin e biznesit;
- Suport i specializuar për zhvillimin dhe konsolidimin e bizneseve që operojnë kryesisht në zonat urbane;
- Gjetjen e burimeve financiare (fondeve) në mbështetje direkte të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Krijimin e mundësisë që mes projektsh periodike të trajnojmë personelin e sipërmarrjeve private, duke i dhënë mundësinë sipërmarrjes private të ketë një personel të kualifikuar dhe më të aftë;
- Bashkia do të mundësojë reklamimin dhe promocionin e të gjitha sipërmarrjeve në Rrjetin Kombëtar Elektronik të Bizneseve (www.albis.al);
- Bashkia Pogradec do të nxisë kooperimin me donatorë dhe partnerë të huaj, duke iu kthyer atyre vëmendjen drejt një terreni me mundësi për zhvillimin dhe konsolidimin e sipërmarrjes private;
- Bashkia Pogradec do i vijë në ndihmë biznesit mes një infrastrukture urbane bashkëkohore, krejtësisht të transformuar, krahasuar me këtë ekzistuese. Një infrastrukturë e tillë urbane do të krijojë shanse edhe për zgjatjen e orarit të funksionimit të bizneseve (atyre që ofrojnë shërbime, dyqaneve etj.);
- Suport për sipërmarrësit e rinj që i drejtohen bankave të nivelit të dytë për 'kredi biznesi', duke iu afruar atyre 'garancinë', kështu do u japim mundësinë për të hedhur më të sigurt hapat e parë në aktivitetin e tyre privat;
- Specialistë të bashkisë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm të saj, do të hartojnë Plan Biznese për të gjithë të rinjtë që dëshirojnë të krijojnë një biznes privat;
- Bashkia Pogradec do të investojë për Pazarin / Tregun e ushqimeve dhe artikujve të tjerë të konsumit të qytetit të Pogradecit, duke përmirësuar kushtet e tregtimit, që sipërmarrësit dhe konsumatorët të mund të shesin dhe blejnë në ambiente të pranueshëm tregtimi;

Mes mbështetjes së biznesit me fonde dhe mes suportit teknik, do të nxisim punësimin, duke e parë këtë si prioritet për shmangien e varfërisë dhe përmirësimin e nivelit të jetesës.

FONDET QË BASHKIA DO TË VJELË NGA BIZNESI NË NJË VIT KALENDARIK, DO TË KENË DESTINACION TË TYRE INVESTIMI, SËRISH HAPËSIRËN SIPËRMARRËSE DHE KONSOLIDIMIN E EKONOMIVE LOKALE, SI E VETMJA RRUGË DREJT MIRËQËNIES, STABILITETIT SOCIAL-EKONOMIK DHE ZHVILLIMIT TË INTEGRUIAR.

Bashkia Pogradec do të ketë bosht të punës së saj Partneritetin Publik-Privat.





Ideja e Partneritetit Publik - Privat


Një marrëdhënie mes një kompanie të sektorit privat dhe një institucioni shtetëror, bëhet me qëllim hartimin dhe implementimin e një projekti që i shërben banorëve, komunitetit. Partneriteti Publik-Privat mund të përdoret për financimin dhe investimin e veprave me interes publik dhe mes këtij partneriteti mundësohet që projekti të implementohet më shpejt dhe të jetë më i sigurt për vazhdimësinë dhe efikasitetin e tij.


Pala publike dhe ajo private mes një marrëveshjeje kontraktuale ndajnë burime financiare, fuqi punëtore, kapital dhe menaxhim, në këtë formë mes marrëveshjes investojnë në një sektor të caktuar, me përfitim të shumëfishtë për palët dhe me objektiv final, komunitetin.

PPP-ja është një shtritje natyrale e sistemeve të ndërthurrura ekonomike. Pushteti Lokal është tashmë koshient për efijencën e strukturave të tij, sepse këto struktura angazhohen kryesisht për zgjidhje problemesh buxheti apo financash, ndaj ekzekutojnë apo implementojnë një projekt, duke kontaktuar me ofrues privatë më efijentë në të mira dhe në shërbimeve. Në këtë formë, struktura e Pushtetit Lokal mund të vazhdojë të nxisë dhe mbështesë axhendën e saj të programeve zhvillimore.

Partneriteti Publik-Privat në disa raste ekziston si hap tranzitor mes një shërbimi publik në një shërbim të privatizuar. Ky koncept, i quajtur korporatizim, synon të ngrehë shtratin rregullator të transformimeve nga publiku tek privati, mes një inkrporimi gradual të vendimeve të bazuara në ligj dhe rregulla.

Ngritja ekonomike drejtohet nga investimet dhe shënjëzohet nga rezultatet produktive, teksa mes investimesh do të ngrehim mundësinë e angazhimit në rradhët e fuqisë punëtore, indivisëve, sot të papunë. **Mes investimesh dhe mes partneritetin me sektorin privat do të gjenerojmë vende pune**, duke përmirësuar nivelik ekonomik të familjeve në Bashkinë Pogradec, me fokus grup-njerëzit e marxhinalizuar.





TURIZMI

do të jetë një Industri e Konsoliduar përpos Standarteve Europiane

Sektori i turizmi, një industri 'kyç', e aftë për t'u shndërruar në 'motorin' lëvizës të përpjekjeve për të ndryshuar ritmin e zhvillimit social-ekonomik afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë.

Bashkia Pogradec përcakton mes këtij Projekti Strategjik format dhe rrugët që do të ndiqen për kthimin e Pogradecit në një destinacioni të rëndësishëm turistik për vizitorë vendas dhe të huaj, duke ofruar eksperiencë të lartë profesionale dhe bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara.

Krijimi i një mjedisi atraktiv, si për vizitorët, ashtu edhe për investitorët, do të jetë fundamenti dhe filozofia e Bashkisë për zhvillimin e Sektorit apo Industrisë së Turizmit.

Projektim i vazhdueshëm për të siguruar:


- Promovimin e turizmit si boshtin kryesor të zhvillimit ekonomik;
- Krijimin e kushteve për tërheqjen dhe afrimin e investitorëve vendas dhe të huaj;
- Krijimin e poleve të reja të atraksionit turistik, mes aktiviteteve që do të fuqizojnë diferencimin e destinacionit turistik;
- Uljen e nivelit të papunësisë, duke nxitur dhe mbështetur hapjen e vendeve të reja të punës;
- Përmirësimin e nivelit jetik, mes konsolidimit të sektorit të turizmit, prej të cilit burojnë afro 40% e të ardhurave në ekonominë e Bashkisë së madhe të Pogradecit;
- Shtrirjen e turizmit në të gjitha sezonet;

Projekti strategjik dhe nën-kategoritë e Industrisë së Turizmit:

- * Turizëm liqenor;
- * Turizëm kondrinor-malor / Agro-turizëm;
- * Turizëm historik & kulturor;
- * Turizëm konferencial;
- * Turizëm alternativ;




Objektiva Afat-shkurtër & Afat-mesëm / Investime & Plan veprimi



- Rehabilitimi i Parkut Kombëtar në Drilon, si një perlë e natyrës, që duhet ta mbrojmë dhe konservojmë, teksa është një prej aseteve më të rëndësishme të turizmit në Pogradec;
- Shtim gradual dhe i qëndrueshëm i mbërritjeve të turistëve dhe grupeve turistike në Pogradec, mes bashkëpunimit me sektorin privat;
- Shtim gradual dhe i qëndrueshëm i qëndrimeve disaditore të turistëve, që do të vijnë si rrjedhojë e ndërhyrjeve në infrastrukturën urbane;
- Forma nxitëse për ta kthyer turistin / vizitorin në konsumator real;
- Shtimi i të ardhurave të sipërmarrjeve që operojnë në sektorin e turizmit (hotele, motele, shtëpi pushimi, shtëpi pritjeje, restorante, taverna, dyqane suveniresh, bar-kafe, night clubs etj.) mes subvencionesh që burojnë nga fonte të strukturave të BE-së dhe organizatave ndërkombëtare;
- Brenda mandatit të parë do të kemi një infrastrukturë turistike tërësisht të rehabilituar dhe kjo do të vijë si fryt i punës dhe bashkëpunimit me sektorin privat;
- Nisma dhe veprime konkrete për Marketing-un dhe promocionin e produktit turistik;
- Trajnimi i personelit të sipërmarrjeve që aktivizohen dhe operojnë në sektorin e turizmit;
- Promocion i Turizmit dhe komunikim i vazhdueshëm me homologë jashtë vendit;
- Krijimi i një strukture të organuar turistike, me partnerë lokalë, rajonalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- Bashkëpunim dhe bashkërendim veprimesh me Shoqatën e Hotelierëve;
- Bashkia Pogradec do të bëjë një punë aktive me Agjensitë Turistike brenda dhe jashtë vendit, mes një Zyre






Informacioni & Marketing-u, për produktin turistik që ofron Pogradeci;

- E-Marketing (Marketing elektronik) përdorimi i teknologjive për promovimin e produktit turistik;
- Mbështetje financiare për të gjitha bizneset që ofrojnë shërbime në sektorin e Turizmit;
- Aktivitete për promovimin e kulinarisë dhe gatimeve tradicionale të zonës së Pogradecit, si element i rëndësishëm në Insutrinë e Turizmit, për tërheqjen e turistëve dhe vizitorëve;
- Mbështetje teknike dhe konsultative për hotelierët, për të ofruar shërbimet e duhura dhe të kërkuara nga klienti turist / vizitor;
- Krijimi i terrenit për një konkurrencë të ndershme të sipërmarrjeve që operojnë në sektorin e Turizmit, duke iu dhënë mundësinë të gjitha bizneseve, të përmirësojnë infrastrukturën që disponojnë, si dhe shërbimet që u ofrojnë turistëve / vizitorëve;
- Reklamimi dhe promovimi i të gjitha bizneseve në Rrjetin Elektronik Kombëtar të Bizneseve;
- Mbështetje e sektorit të Turizmit mes spotesh dhe reklamash promovionale, në kanalet televizive kombëtare, në rrjetet elektronike televizive brenda dhe jashtë vendit. Gjatë periudhës së pranverës Bashkia do të mundësojë reklamimin e Turizmit të Pogradecit, në televizione prestigjioze të disa vendeve të rëndësishme të Europës (Gjermani, Francë, Suedi, Austri, Zvicër);
- Botime artikujsh për promovimin e Turizmit në Pogradec, në revista prestigjioze kombëtare, si dhe në revista prestigjioze europiane ("Europe Tourism", "Travel and Tour", "Destinations Europe", "Traveller" etj.);
- Hartimi dhe botimi i Guidës Turistike të Bashkisë Pogradec;
- Vendosja në sheshin qendror të qytetit të Pogradecit, e një mega-monitori për promovimin e turizmit, për reklamimin e biznesit që operon në sektorin e Turizmit, për njoftimin e aktiviteteve dhe eventeve që do të zhvillohen në Bashkinë Pogradec (në qytet dhe në fshatrat e tij). Mega-monitori do të jetë një ekran informues, reklamator, sugjerues, për vendasit dhe vizitorët, duke iu ofruar vizualisht asetet turistike që ofron Pogradeci;

- Ndërtimi i mini-moleve përgjatë gjithë vijës bregliqenore nga Tushemishti në Lin, që do të shërbejnë si pika stacionimi për mjetet e vogla të lundrimit, si ura shëtitjeje për këmbësorët, si vendqëndrime çlodhjeje dhe soditjeje të mjedisit të mrekullueshëm hidrik që ofron Liqeni i Ohrit;
- Krijimi i dy terreneve sportive (fusha mini-futbolli & basketbolli), pranë bregliqenit, respektivisht në Buçimas dhe në Udënisht, për banorët, për të rinjtë dhe për të gjithë vizitorët dhe turistët, që do të kalojnë kohën e lirë gjatë ditëve të tyre të pushimit në Pogradec;
- Nxitje dhe mbështetje për organizim e garave, apo lojrave që zhvillohen në ujë, në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.
- Organizmi i hapësirës Camping, funksionale përgjatë gjithë vitit, ku do të mund të stacionojnë turistët/vizitorët.
- Bashkëpunim me sportistë në Europë dhe jo vetëm, që ushtrojnë sporte ekstreme në ujë. Kjo do të jetë një formë shumë efektive promovimi, teksa Bashkia shtrihet në një prej liqeneve më të mëdhenj të Europës;
- Për periudhën Korrik - Shtator, do të funksionojë Kinemaja Verore pranë bregliqenit, për të gjithë kalimtarët dhe vizitorët, do të jetë një mundësi më shumë argëtimi dhe relaksi, por edhe edhe një formë për të përçuar kulturën e filmit tek të gjitha moshat.
- Organizimi një herë në vit i ditës "Kantina e Verës", në një prej zonave rurale të Bashkisë Pogradec, e shquar për vreshtari. Ky organizim do të jetë një traditë e përvitshme, me efekt në disa sektorë dhe që do të sjellë kryesisht vizitorë nga Bashkitë përreth, por edhe vizitorë nga Bashkitë e tjera të Shqipërisë dhe nga Kosova;
- Mbështetje teknike dhe financiare për bizneset që do të ofrojnë shërbime në Agro-turizëm, teksa duhen hedhur





dhe mbështetur hapat e parë edhe në këtë drejtim, që sot pothuajse nuk ekziston, por që mund të kthehet në formë alternative turizmi, kur zona rurale e Pogradecit të ketë marrë fizionominë e duhur përsa i përket infrastrukturës dhe zhvillimit të ekonomive lokale (fermerë, blegtorë);

- Hartimi dhe botimi: "Harta e Itinerarit Turistik në Bashkinë Pogradec", në disa gjuhë.
- Mirëmbajtja dhe kthimi në të vizitueshme, i Bazilikës së Linit. Kjo vepër e trashëguar nga thellësitë e kohëve, duhet të jetë sot e vizitueshme prej gjithkujt që shkon në Lin, duke patur mundësinë që ta shohë;
- Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i territoreve përreth monumenteve të kulturës Bizantine dhe post-Bizantine, objekteve të kultit, si dhe kthimi i tyre në destinacion turistik. Mundësimi për të qënë të vizitueshme, duke patur parasysh vlerat e mëdha historike dhe kulturore që mbartin.
- Promovimi i monumenteve të historisë dhe kulturës, fesë dhe besimit, të trashëguara në shekuj, mes botimit të Albumit Fotografik "Monumentet e Kulturës / Bashkia Pogradec", që do të jetë një ndër dokumentet më të vlefshëm për promovimin e gjithë zonës, teksa interesimi, kryesisht i të huajve, për këto monumente është i madh. Këto monumente do të mund t'i vëmë kështu, në vëmendje të specialistëve restauratorë dhe ekspeditave shkencore-kërkimore universitare, të interesuar për të punuar në Shqipëri, për t'i kthyer këto monumente në identitet, mes fondesh nga organizata ndërkombëtare, mes partneritetesh ndër-shtetërore, të fokusuara në mbrojtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore, si dhe mes projektesh të Këshillit Europian, UNESCO etj., fokusuar tek e njëjtja tematikë, mes bashkëpunimesh shumëpalëshe;
- Organizimi i përvitshëm i Javës së Filmit Ballkanik. Mes arti dhe kulturës, mbështetim turizmin, promovojmë Pogradecin;
- Organizimi i Panairit Kombëtar të Turizmit Alternativ, një aktivitet i përvitshëm, që do të kthehet në traditë dhe për të cilin do të bashkëpunohet me strukturat përkatëse shtetërore;
- Nxitja e nismës "Qytet i Gjerbër Qytet i Pastër". Fëmijë të shkollave 9-vjeçare dhe të rinj të Bashkisë, që do të dëshirojnë të jenë vullnetarë të qytetit, do të mblidhen çdo fundjavë, nën kujdesin e Bashkisë, për t'i ofruar shërbime sociale qytetit dhe bregliqenit, nën slloganin "Qytet i Gjerbër Qytet i Pastër", për periudhën Qershor - Gusht, si një nismë që do të mbështesë fuqimisht sektorin e turizmit;

Lake Rock

Music Nights
Pogradec - Albania






EVENTI I VITIT “LAKE ROCK” Music Nights

“Lake Rock” - Netë Muzike, do të jetë aktiviteti i përvitshëm 3-ditor, që do të organizohet përgjatë bregliqenit në qytetin e Pogradecit (fundjavën e dytë të Gushtit), ku do të marrin pjesë grupe dhe banda muzikore ‘rock’, nga Shqipëria dhe vende të tjera.

“Lake Rock” - Netë Muzike, do të jetë aktiviteti që do të sjellë mijëra të rinj dhe fans-a të muzikës ‘rock’ nga e gjithë Shqipëria, duke e kthyer Pogradecin në qendër të muzikës dhe argëtimit.


Ambasadat e disa shteteve të huaja në Shqipëri do të jenë partnerët dhe mbështetësit tanë, për të sjellë banda “rock” nga vendet e tyre, përkrah muzikantëve brilantë shqiptarë, për të marrë pjesë në këtë ‘Event’ të muzikës ‘live’.



BASHKË

BASHKË





PËR POGRADECIN

PËR POGRADECIN

NGA TAKIMET ME BANORËT REGJISTRUAM KËTO KËRKESA PËR 7 NJËSI ADMINISTRATIVE TË BASHKISË POGRADEC

Kërkesa, problematika, sugjerime për investime, mirëmbajtje dhe ndërhyrje emergjente, të ngritura nga banorët gjatë takimeve që realizuam me ta, duke i dëgjuar vëmendshëm.

Të gjitha këto kërkesa dhe problematika do të jenë në fokusin e punës së përditshme të Bashkisë, duke menaxhuar me seriozitet dhe përgjegjshmëri publike çdo kërkesë dhe çdo metër katror të territorit që do të administrojmë.


NJËSIA ADMINISTRATIVE BUÇIMAS


Fshati Vërdovë

1. Problemet me ujin e pijshëm;
2. Ndërtimi i rrugës;
3. Sistemimi i varrezave;
4. Rregullimi i oborrit të shkollës;
5. Rehabilitimi i rrjetit të amortizuar elektrik në zonën sipër;
6. Dhënia e ndihmës ekonomike familjeve në nevojë;
7. Sistemimi i lumit;
8. Gjetja e formave për të luftuar papunësinë e theksuar;
9. Ndriçim rrugor;

Fshati Zagorçan

1. Problemet me ujin e pijshëm;
2. Dhënia e ndihmës ekonomike;
3. Investime në sistemin e kullimit dhe vaditjes së tokave bujqësore;
4. Mbështetja e blegtorisë dhe bujqësisë;
5. Rehabilitimi i rrjetit rrugor dhe ndriçimit;





Fshati Rëmenj

1. Masa për shmangien e mbifaturimit të ujit të pijshëm;
2. Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza;
3. Rehabilitimi i sistemit të kanaleve ujitëse dhe vaditëse;
4. Dhënia e ndihmës ekonomike familjeve në nevojë;

Fshati Zërvaskë

1. Ndrigimi rrugor;
2. Sigurimi i ujit të pijshëm;
3. Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza;
4. Rehabilitimi i sistemit të kanaleve ujitëse dhe vaditëse;
5. Sistemimi i varrezave të fshatit;
6. Restaurimi i shkollës;

Fshati Starovë

1. Mirëmbajtja e rrjetit rrugor të brendshëm;
2. Ndërtimi i sistemit të kanaleve ujitëse dhe vaditëse;
3. Hidrovori i kullimit;
4. Sistemimi i ujërave të zeza;
5. Dhënia e ndihmës ekonomike familjeve në nevojë;
6. Iniciativa për uljen e papunësisë;

NJËSIA ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË

Fshati Çërravë

1. Kanalizimi i ujërave të zeza;
2. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve të brendshme të fshatit;
3. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm;
4. Rregullimi i kanalit vaditës Plloçë - Çërravë;

Fshati Leshnicë

1. Rehabilitimi i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit;
2. Sistemimi i ujërave të zeza;
3. Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve;

Fshati Qershizë

1. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm;
2. Sistemimi i ujërave të zeza;
3. Dhënia e ndihmës ekonomike në nivelin e duhur, familjeve në nevojë;


Fshati Lumas

1. Ndriçimi rrugor;
2. Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme;
3. Asfaltimi i rrugës Çërravë - Lumas;

Fshati Petrushë

1. Furnizimi me ujë të pijshëm / Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm;
2. Rikonstruksioni i shkollës së vjetër 9-vjeçare;
3. Sistemimi i kanaleve ujitëse dhe kulluese;
4. Rregullimi i rrjetit të brendshëm rrugor;





Fshati Nizhavec

1. Asfaltimi i rrugës Petrushë - Nizhavec;
2. Rikonstruksioni i shkollës fillore;
3. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm;
4. Sistemimi i rrugëve të fshatit;
5. Sistemimi i kanaleve kulluese;

Fshati Grabovicë

1. Ndrëqimi rrugor;
2. Sistemimi i varrezave të fshatit;
3. Sistemimi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe të bardha;
4. Sistemi i kanaleve vaditëse;
5. Mirëmbajtja e rrugës;
6. Zgjidhja e problemit të tokave që nuk figurojnë në kadastër;

Fshati Alarup

1. Ndrëqimi rrugor;
2. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm / Rikonstruksioni i rrjeti të brendshëm;
3. Sistemimi i rrugëve të brendshme, mbi rrugën kryesore;
4. Transporti i fëmijëve në shkollë;

Fshati Bletas

1. Sigurimi i ujit për vaditjen e tokave;
2. Ndërtimi i këndit sportiv;
3. Sistemimi i kanaleve të ujërave të zeza;
4. Ndihmesë për pajisjen e banorëve me çertifikatë pronësie të banesave të tyre;
5. Ndrëqimi rrugor;

NJËSIA ADMINISTRATIVE DARDHAS


Fshati Beragozhde

1. Hapja e rrugëve në parcelat e tokave bujqësore;
2. Mirëmbajtja e rrugëve të brendshme;
3. Ndërtimi i ujësjellësit;
4. Vendgrumbullimi i mbetjeve;
5. Mirëmbajtja e rrugëve të brendshme;

Fshati Stropskë

1. Sistemimi i rrugëve të lagjeve;
2. Ndriçimi i rrugëve;
3. Patrimi i fshatit nga mbetjet urbane dhe organike;
4. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza;
5. Gjetja e tregjeve për shitjen e produkteve;
6. Hapja e rrugëve në parcelat e tokave bujqësore;
7. Mirëmbajtja e varrezave, si dhe shtrimi i rrugës që të çon tek varrezat;
8. Largimi / vendosja e stallave në periferi të fshatit;
9. Sigurimi i ujit të pijshëm;





NJËSIA ADMINISTRATIVE PROPTISHT

Fshati Radokal poshtë & Radokal sipër

1. Furnizimi me ujë të pijshëm;
2. Sistemi i vaditjes dhe ujitjes;
3. Sistemimi i rrugës kryesore dhe rrugëve të brendshme;
4. Mbështetja e bujqësisë dhe blegtorisë;

Fshati Homezh

1. Ndërtimi i rrugës;
2. Ndalimi i shpyllëzimit;
3. Ndërtimi i rrugës Homezh - Çervenakë;
4. Sistemimi i rezervuarit dhe kanaleve ujitëse;

Fshati Zall Torre

1. Ndërtimi i urës kryesore që lidh Zall Torre me Golikun;
2. Ndrigimi rrugor;
3. Sigurimi i ujit të pijshëm;
4. Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve;
5. Sistemimi i kanaleve vaditëse dhe sigurimi i ujit për vaditje;

Fshati Slabinjë

1. Ndërtimi i rrugës;
2. Sigurimi i ujit të pijshëm;
3. Sigurimi i ujit për vaditje;
4. Pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve dhe largimi i tyre nga fshati;

Fshati Golik

1. Ndërtimi i rrugës Golik sipër;
2. Ndërtimi i rrugës së varrezave;
3. Furnizimi me ujë të pijshëm;
4. Ndrigimi rrugor;
5. Sigurimi i ujit për vaditje;

NJËSIA ADMINISTRATIVE TREBINJË

Fshati Trebinjë

1. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve;
2. Ndrëqimi rrugor;
3. Ndihma ekonomike të jepet tek familjet në nevojë;

Fshati Pleshisht

1. Ndërtimi i rrugës kryesore;
2. Ndërtimi i ujësjellësit;
3. Sistemimi i kanaleve vaditëse;


Fshati Dunicë

1. Ndërtimi i rrugës kryesore;
2. Ndërtimi i rrugës që lidh me Gurin e bardhë;
3. Furnizimi me ujë të pijshëm;
4. Sistemimi i kanaleve vaditëse;

Fshati Malinë

1. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugës;
2. Sistemimi i kanaleve vaditëse;
3. Mbështetja e sektorit të blegtorisë;





NJËSIA ADMINISTRATIVE VELÇAN

Fshati Velçan

1. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe rehabilitimi i rrjetit kryesor dhe linjave të brendshme;
2. Sistemimi i kanaleve ujitëse;
3. Menaxhimi i rezervuareve;

Fshatrat Bishnicë / Shpellë / Jollë

1. Ndërtimi i rrugës në lagjen Lufo;
2. Riparimi i ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjetit të brendshëm;
3. Sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza;
4. Përmirësimi i godinave të shërbimit shëndetësor;

Fshatrat Buzaishtë

1. Sistemi i kanale vaditëse;
2. Përfundimi i punimeve për ndërtimin e rrugës që lidhet me fshatin Bishnicë;
3. Furnizimi me ujë të pijshëm;
4. Hapja e rrugëve në parcelat e tokave bujqësore;

Fshati Laktesh

1. Ndërtimi i rrugës që lidh me tregun e fshatit Proptisht dhe rrugët dytësore;
2. Furnizimi me ujë të pijshëm, ndërtimi i ujësjellësit;
3. Sistemi i rrjetit të kanaleve vaditëse dhe ujitëse;
4. Rikonstruksioni i qendrës shëndetsore dhe funksionimi i saj;

Fshati Losnik

1. Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare;
2. Sistemi i ujitjes;
3. Ndërtimi i rrugës kryesore;

NJËSIA ADMINISTRATIVE UDËNISHT

Fshati Udënisht

1. Furnizimi me ujë të pijshëm / Investim për depon e ujit;
2. Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza;
3. Sistemi i kanaleve ujitës dhe vaditës;
4. Sistemimi i rrugëve;
5. Sistemimi i lumit;
6. Mirëmbajtja e terreneve sportive;
7. Pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve;
8. Transporti brenda Bashkisë të bëhet me furgonë të vegjël;
9. Pastrimi i liqenit dhe bregliqenit;
10. Mbështetje për bujqësinë;
11. Përpjekje për uljen e nivelit të papunësisë;


Fshati Memëlisht

1. Ndërtimi i rrugës;
2. Furnizimi me ujë të pijshëm;
3. Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza;
4. Pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve;
5. Dhënia e ndihmës ekonomike banorëve dhe familjeve me probleme të mëdha sociale dhe ekonomike;
6. Përpjekje për uljen e nivelit të papunësisë;

Fshati Çervenakë

1. Ndhimesë për përmbushjen e procedurave për shtëpitë e palegalizuara;
2. Ndërtimi i rrugës;
3. Furnizimi me ujë të pijshëm;
4. Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza;





Fshati Boqezë

1. Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza;
2. Investime infrastrukturore për vaditjen dhe ujitjen;
3. Ndihmesë për uljen e nivelit të papunësisë;
4. Pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve;

Fshati Lin

1. Ndihmesë për nxitjen e turizmit familjar;
2. Vendosja e pompave për vaditjen e tokave bujqësore;
3. Krijimi i tregut për shitjen e produkteve bujqësore dhe pijes së verës;
4. Pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve;
5. Ngritjen e nivelit të ndihmës ekonomike dhe rishikimi i listës së përfituesve;


Fshati Piskupat

1. Projekte për mbështetjen e sektorit të bujqësisë;
2. Pastrimi dhe grumbullimi i mbetjeve;
3. Vendosja e pompave për vaditjen e tokave bujqësore;
4. Ndihmesë sektorit të peshkimit;

PUNĚ

PUNĚ





dhe DINJITET



Eduart KAPRI

Lindi më 9 Maj 1970

I martuar me zj. Jerina Kapri (Hoxhallari), babai i tre fëmijëve, Dei, Erik dhe Eda.

Në vitin 1988 përfundoi studimet e mesme në Shkollën e Mesme Profesionale Tregtare në qytetin e Vlorës.

Në vitin 1992 u diplomua në Degën e Financave, Fakulteti Ekonomik, pranë Universitetit të Tiranës.

Në vitin 2007 u kualifikua nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar, mbi "Standartet Kombëtare të Kontabilitetit".

Përdorues shumë i mirë i disa programeve kompjuterike.
Njohës shumë i mirë i gjuhëve të huaja: Gjermanisht & Italisht.

Eksperiencia Profesionale

1992-1993 _ Shef Ilogarie në Ndërmarrjen e Ndërtimit të Pogradecit.

1993-1998 _ Jetoi dhe punoi në Gjermani.

1998-2002 _ Administrator i një sipërmarrjeje në sektorin privat .

2002-2003 _ Përgjegjës i Qendrës Ekonomike, pranë Qendrës Arsimore Rajonale Pogradec.

2004 dhe në vazhdim _ Administrator i kompanisë "Real-2", me seli në Pogradec, që operon në sektorin e importit dhe tregtimit të duhanit.


Prej vitit 2005 _ operon në sektorin e ndërtimit, si aksioner në një prej kompanive më prestigjioze të konstruksioneve, në qytetin e Pogradecit.


Angazhimi Politik

2001 & 2005 _ Kandidat për deputet në Kuvendin e Shqipërisë

2011 dhe në vazhdim _ Kryetar i Këshillit Bashkiak Pogradec

Individ me eksperiencë shumëvjeçare në funksionimin, drejtimin dhe administrimin e Pushtetit Vendor.





Eduart Kapri



Eduart KAPRI

